

BËNI KUJDES!

Veprimtaria e sigurimit dhe veprimtaria e ndërmjetësimit në sigurime mund të kryhet vetëm nga shoqëritë e sigurimit dhe ndërmjetësit në sigurime (agjentë, shoqëri agentësh, broker, shoqëri brokerimi) të licencuar apo të miratuar nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare.

Por fatkeqësisht, mund të ndodhë që persona të palicencuar t'ju ofrojnë kontrata të sigurimit fallco ose të prezantohen duke përdorur në mënyrë të paautorizuar emrin e shoqërive të licencuara.

Blerja e produkteve të sigurimit pranë një shoqërie, apo ndërmjetësi të palicencuar është objekt mashtrimi dhe spekulimi.

Ndiqu këto 5 hapa për t'u siguruar që ju po kontaktoni me shoqërinë apo ndërmjetësin e licencuar nga AMF dhe të mbron veten nga mashtrimet.

Hapi 1. Kontrolloni nëse shoqëria e sigurimit është e licencuar nga AMF

Kontrolloni në faqen zyrtare të internetit të AMF-së link <http://amf.gov.al/>, nëse shoqëria e sigurimit me të cilën keni kontaktuar është e licencuar nga Autoriteti për të ushtruar veprimtari sigurimi në Republikën e Shqipërisë.

Lista e personave që kanë të drejtë të urshetrojnë veprimtari sigurimi në Republikën e Shqipërisë gjendet e publikuar në faqen zyrtare të AMF në linkun "Rregjistri i të licencuarve".

Hapi 2. Kontrolloni nëse ndërmjetësi në sigurime është i licencuar nga AMF

Kontrolloni në faqen zyrtare të internetit të AMF-së link <http://amf.gov.al/>, nëse personi me të cilin keni kontaktuar është i licencuar/miratuar nga Autoriteti për të ushtruar veprimtarinë e ndërmjetësimit në sigurime në Republikën e Shqipërisë.

Lista e personave që kanë të drejtë të urshetrojnë veprimtari ndërmjetësimi në sigurime në Republikën e Shqipërisë gjendet e publikuar në faqen zyrtare të AMF në linkun "Rregjistri i të licencuarve".

Hapi 3. Bëni disa verifikime shtesë dhe ... shikoni me kujdes detajet

Kontrolloni nëse informacioni që ju është dhënë korrespondon me informacionet e publikuara në në faqen zyrtare të internetit të AMF-së apo në faqen zyrtare të shoqërive të sigurimit.

Nëse keni dyshime, kontaktoni me shoqërinë e sigurimit për të marrë më tepër informacion pranë shoqërisë së sigurimit. Cdo shoqëri sigurimi ka faqen zyrtare të internetit ku publikon informacione rreth saj dhe produkteve të sigurimit që ofron.

Lexoni me kujdes dhe kontrolloni të dhënat e vendosura në kontratën e sigurimit (policën e sigurimit). Kujdes nëse konstatooni se policia e sigurimit ka korrigjime, fshirje apo pjesë të palexueshme qartë Edhe pse mund të duken gabime të vogla dhe të parëndësishme mund të keni në dorë një policë të fallsifikuar.

Hapi 4. Konsultoni paralajmërimet e AMF-së

Kontrolloni listën e njoftimeve paralajmëruese të publikuara nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare në faqen zyrtare të internetit link <http://amf.gov.al/kujdes.asp>. AMF publikon vazhdimisht njoftime specifike për të informuar publikun në mënyrë që të parandalojë rrezikun nga mashtrimet apo spekulimet .

Hapi 5. Na telefononi nëse keni dyshime

Për më shumë informacion ose për të raportuar një rast të mundshëm abuziv, kontaktoni në adresën elektronike konsumatori@amf.gov.al apo në numrin e tel +355 4 222 8260 nga e hëna deri të premtën.